

UDHËZIM
Nr. 15, datë 17.6.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE RREGULLAVE TË MËNYRËS SË
APLIKIMIT PËR SHTYRJEN E AFATEVE PËR LEJET MINERARE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të vendimit nr. 111, datë 2.3.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”,

UDHËZOJ:

1. Zotëruesit e lejeve minerare, që aplikojnë për shtyrje afati për lejet e tyre minerare, duhet të paraqesin kërkesën e aplikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Kërkesa duhet të përmbajë një informacion të plotë për realizimin e detyrimeve të lejes së tyre minerare, në përputhje me kushtet e lejes dhe detyrimet, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe arsyet e shtyrjes së afatit të lejes.

2. Strukturat përgjegjëse, sipas tipit të lejes, realizojnë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e kërkesës, vlerësimin e kërkesës për shtyrje afati. Ky vlerësim përfshin verifikimin e realizimit të detyrimeve të zotëruesit të lejes minerare, si nëpërmjet dokumentacionit teknik, ekonomik, mjedisor, ashtu edhe nëpërmjet verifikimit në terren. Strukturat përgjegjëse paraqesin për miratim në ministri vlerësimin përkatës për shtyrjen e afatit, si dhe arsyet e kësaj shtyrjeje.

3. Ministri, brenda një afati prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së dokumentacionit të plotë, nxjerr aktin e miratimit ose të refuzimit të shtyrjes së afatit të një leje minerare, të cilin e dërgon në QKB.

4. Të gjitha subjekteve, që në përputhje me ndryshimet e legjislacionit mineral, kanë aplikuar për zgjatje afati para miratimit të këtij udhëzimi, do t’u vlerësohet kërkesa, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të këtij udhëzimi.

5. Për rastet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij udhëzimi, për zonën e lejuar minerare për të cilën kërkohet shtyrje në afat, kërkuesi ka të drejtën ekskluzive për plotësimin e dokumentacionit përkatës për këtë zonë, sipas afateve kohore të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

6. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku